


NORMALISTI

Jo në dijën, por në vullnetin e fortë
qëndron vlera e njeriut

HERBART



©MIMI i Lek

NORMALISTI

Revistë e Përmujshme: Pedagogjike, Letërore e Shkencore

Botohet prej Nxanësve të Shkollës Normale

Editor: POSTOL LI TANEF '35

Sekretari: SOTIRAQ CACI '36

Arkëtar: SPIRO MIHILLI '35

Ndihmësa: XHELADIN NDREU '38
APOSTOL RUCO '38
NAKO KOKA '39

Drejtimi: Revista "NORMALISTI"

SHKOLLA NORMALE - ELBASAN

Pajtimi: Për gjashtë numura 1 Fr. ar

Mbrendija

| | faqe |
|--|------|
| 1. Helm e Vaj | 2 |
| 2. Pajtimtarëve | 3 |
| 3. Ngrija e Fëmijëve | 4 |
| 4. Fjalimi i mbajtun me rastin e Njëzetit-pes vjeçorit | 5 |
| 5. Me rastin e njëzetit-pes vjeçorit (vlershë) | 11 |
| 6. Vlera edukative që përfaqëson mësimi mbi natyrën | 13 |
| 7. Mësimet e para të Miss Jones-it | 15 |
| 8. Provë mësimi | 17 |
| 9. Kolonit Shqiptare n' Apuli | 18 |
| 10. Kënga e Lenorës në poezi të Shqiptare | 19 |
| 11. Dashuri e vërtetë | 22 |
| 12. Bregu i lotëve | 26 |
| 13. Ndërgjegjia | 27 |
| 14. Qyteti i im | 27 |
| 15. Lutja e rëmbyerë | 28 |
| 16. Në ëndërrime | 28 |
| 17. Kujtim | 29 |
| 18. Randësia e veprës së mësimi për shoqëri të shtet | 30 |
| 19. Pësapa e vogël | 31 |
| 20. Të reja pedagogjike | 32 |
| 21. Kangë e Serbis | 33 |
| 22. Kujtimi | 33 |
| 23. Vata dhe lloja | 34 |
| 24. Anekdota nga jeta e Napoleonit | 35 |
| 25. Oshelma e muajve Nëntor-Dhujor | 36 |

Fjalimi i mbajtur me rastin e 25 Vjetorit të Shkollës Normale.

Prej Drejtorit të Shkollës s'onë A. Xhuvani

Jemi mbledhë sot këtu, që të kujtojmë njizet- e pesëvjetorin e çeljes së shkollës normale këtu n' Elbasan. Si sot njizet e pesë vjet më 1909 më 18 të Nandorit alla turka u-hap këtu e para shkollë normale shqipe. Hapjen e kësaj shkolle e vendosi Kongresi që u-mbajt këtu n' Elbasan më 20-28 të Gushtit 1909 dhe ku muerën pjesë 20 e sa klube që u-hapën asaj kohe në gjith' anët e Shqipnisë. Ky Kongres, kryetar i të cilit u-zgjoth Dervish Be Biçakçiu, ndërmjet vendimevet të tjera muer edhe vendimin që të hape këtu n'Elbasan një shkollë normale. Vendimi atëhershëm i Kongresit thoshte tektualisht këto. "të fillonet dhe të nisët këtë Vjeshtë ndë Elbasan një mësonjëtoore për mësonjës me gjashtë rrjeshta, për të përmbajturit e së cilës janë detyruarë tërë klubet dhe shoqëritë mbrënda dhe

jashtë Shqipërisë, sikundër dhe tërë njerëzit që dëshirojnë përrparimn' e kombit shqiptar". Përveç kësaj n'at Kongres u-vendos dhe kjo: "të fillonet një shoqëri qendrale në Korçë me emërin "Përparimi", e cila do të njihet prej mbledhjes së Kombit (Parlamentit të Turqisë) si personë morale dhe juridike dhe e cila do të jetë arka e përgjithëshme, ku do të mblihdhen tërë të hollat, që do të dërgojnë klubet, shoqëritë si dhe gjithë mirëdashësit e Kombit shqiptar. Kjo shoqëri—thoshte ai vendim i Kongresit—do të përkujdeset pikë së pari, që të përmbanë një mësonjëtoore për mësonjës (d.m.th. një shkollë normale) ndë Elbasan edhe do t'u ndihnjë, me sa t'ki mundët, të tëra shkollavet shqipe, të cilat nuk mundin të përmbaher plotërisht prej atyreve që i kanë çelur; edhe do të ndihnjë që të shtypnjë libra shkollare të vëjyera dhe të nevojshëme, pasi të squronen prej njëj Komisioni të vëndësve të kësaj shoqërije".

Kongresi i Elbasanit muer edhe të tjera vendime, po vendimet kryesore t'atij Kongresi kanë qënë këto tri: 1) hapia e shkollës normale këtu n' Elbasan; 2) themelimi i shoqënisë «Përparimi» në Korçë dhe 3) zgjedhja e klubit të Manastirit si klub qendral i gjithë klubevet të tjerë të Shqipnisë.

Si mbas vendimeve të Kongresit t'Elbasanit dhe të projektit që u-ngarkue të hartojë Komisioni i zgjedhur prej këtij Kongresi, shkolla normale do të kishte 6 klasë, nga të cilat tri do t'ishin "për të përgatitur" dhe tri të tjerat fjesht normale. Kursi i tri klasëvet të para u-quejt "premtare"; në klasën e parë të këtij kursi do të hyjshin nxanës "që kishin mbaruar një shkollë të parë të çfarëdo gjuhe dhe në klasët e tjera ata "që kishin mbaruar klasë më të lartëra". Shkolla normale mbas vendimit t'atij Komisioni, do të qeverisej prej njëj pleqësije prej tetë vetash Elbasanas, të cilët do të zgjidheshin nga pleqësit' e bashkueme të klubit e të shoqënivet

Ardh si rrefta në Shqipni
Drit t'i jepë po liri
Trup e jetë pa peshue
Shqipërin veç me lirue

Dëboi Kuçedrat mizore
Q' ishin në tokën arbënore
Me shpatën e zjart të tija
I nxori nga Shqipëria.

Tokën shqiptare lirojti
Dhe trimnin e tij tregojti
I dha botës të kuptojë
Se shqiptar' i lir do t' rojë
Ky pra asht Zogu i parë
Q' i na sot e kemi t' parë.

Urdhni t'ija do t'i bindem
Gati ç'do rast do t'i gjindem
Do bërtas me brohorrija
Roft atdheu i yn Shqipria

Flamuri nga her' valoftë
Roftë Zogu i parë Roftë.

Gjorgj Simo



Komisioni dhe Profesorët e Normales së parë më 1909-1910.

‘Elbasanit për dy vjet. Drejtori i normales do të pazehej “gjer më 150 lira turke në mot, tre profesorë gjer më 300 lira dhe tre mësorjës të tjerë gjer më 250 lira”; nxanësit do t’ishin të mbrendshëm e të jashtëm. Mësimet që do të mësoheshin në normale ishin këto: 1. Matematikë. 2. Numratorë, Gjeometri, Algjebrë, Trigonometri, Astronomi, Mekanikë, etj. 3. Fizikë dhe Kimi. 4. Istori të naturës, Anatomi, Fisiologji, Zoologji, Botanikë, Gjeologji, Mineralogji, etj. 5. Gjuha shqip: Shkronjëtorë, Sintaks, Literaturë, Retorikë, Poetikë. 6. Gjuha turqisht. 7. Gjuha anglisht dhe greqisht me u thënë kush të dojë. 8. Filozofi: Psikologji, Logjikë dhe Pedagogji. 9. Fetë: Musulmane, Ortodokse dhe Katolike. 10. Gjeografi. 11. Istori: Istori të përgjithshme, të Turqisë dhe të Shqipërisë. 12. Desen. 13. Muzikë. 14. Gjymnastikë.

Sikurse u-tha, shkolla normale do të mbahej prej ndihmave të klubeve, të shoqërive shqiptare dhe të çdo tjetër privati, qi dishronte t’i ndihmonte Arsimit. Së parit u-mblodhën prej gjithë viseve të Shqipërisë 563 lira turke, por ndihmat nga gjithë anët e Shqipërisë si edhe nga Shqiptarët e jashtëm, vijuan të mbledheshin gjithënjë dhe i dërgoheshin shoqërisë “Përparimi” në Korçë, e cila, si u-tha, ishte arka e përgjith-

shëme për të përmbajtur normalen dhe ndonji shkollë tjetër e për nevojë të tjera arsimore.

Më 8 të Tetorit 1909 Kryetari i Komisionit të shkollës normale, Dervish Be Biçakçiu, shpalli një thirrje në gazetën “Bashkimi i Kombit” të Manastirit, ku përmendje se Normalja hapi dyert për të nshkrue nxanës më 24 t’atij muej dhe më tre të muejit që vinte, d.m.th. të Nandorit, do të niseshin mësimet. Mirë po, mbassi personeli i shkollës erdhi vonë, shkolla u-hap më 18 të Nandorit, më ora 5 të mëngjezit alla turka, d.m.th. si sot më 1 të këtij mueji, tue që-në aty pranë parësia dhe autoritetet e vëndit dhe një shumicë e madhe prej popullit.

Asht e tepërme të theksohet entuziazmi i atëherëshëm jo vetëm i gjithë popullit ‘Elbasanit, por edhe i gjithë Shqipërisë për hapjen e normales, pse kjo realizonte një andërr të vjetër të Shqiptarëve, të dalunit në dritë, mbas kaq shekujsh, të gjuhës shqipe, ringjalljen e ndërgjegjës komtare, fillimin e kulturës së popullit me anë të gjuhës së vet dhe një hap të math drejt qytetimit dhe lulëzimit të kombit.

Normalja që u-hap atëhere kishte tri klasë, që kishin mësimet thuejtë të një shkollë qytetaje, dhe vjetin e ardhshëm ishte mendimi që të hapet e para klasë e normales së mirëfilltë. Mxa-




Profesorët, nxanësit dhe Komisioni i Normales së parë më 1909-1910.

nësit së parit nuk ishin aqë shumë, por mba-sandaj, mbas nji mueji, u-shtuen e u-banë gjithsej 140, nga të cilët 70 ishin Kosovas; lëshin të jashtëm dhe internatistë, bur-sistë të mbajtur prej klubevet të ndryshëm të Shqipnisë. Profesorë e mësues ishin gjithsejt te-të vetë, të paguem, sikurse u-tha ma nalt, prej arkës së shoqënisë "Përparimi" të Korçës, tek e cila dërgoheshin ndihmat e Shqiptarëvet prej gjithë anëvet. Mësimet, mbassi nuk kishin atëhere asnji libër shkolle, bësheshin të tana me shkrim; nuk ua diktojshim nxanësvet mësimet, por i shkrueshim vetë më parë, i nxirshim mba-sandaj në poligraf e kështu në fletë të veçanta në formë dispensash, ua shpërndajshim nxanës vet. Mbassi ishte e para herë që po mësojshim lëndë të ndryshme në gjuhë shqip, e mba-mend se kemi hekë njaft zi e mund tue ua fti-lloe nxanësvet mësimet në gjuhë shqipe e tu, u-mundue me gjetë termat e fjalët e duhuna për t'i çfaqë mendimet në gjuhët t'onë.

Shkolla normale vijoi punën gjithë vjetin shkolluer 1909-1910 dhe në Qërshuer u-banë provimet me gojë e me shkrim; më 25 të këtij mueji u-ba edhe nji provim i botshëm përpara autoritetevet dhe popullit të vendit, tue u dhanë nxanësvet dëftesat vjetore dhe çmime atyne ma të zellshëmvet.

Mirë po themelimi i shkollës normale t'Elba-sanit, i nji shkolle tjetër shqipe në Korçë dhe i shkollavet të tjera ndër vise të tjera të Shqipë-nisë, aktiviteti që zunë të shtjellojnë klubet e ndryshme të Shqiptarëvet, për të përhapë ndje-njat kombëtare në popull, lëvizja komtare e fillueme për të bashkue el-mentet e ndryshme e për të bëmë gati nji jetë të re e më vehte të kombit, kryengritja mbasandaj e Kosovës, të gjitha këto suellnë një reaksion nga ana e Qe-verisë turke të Stambollit, e cila përdori çdo mjet për të pengue e për të çdukë çdo zgjim të ndjenjavet komtare tue qitë çashtjen e shkro-vet arabishte për shkrimin e Shqipes, tue bā-më gjithëfarë intrigash e tue futë fanatizmin në popull, me qëllim që të paralizojë bashkimin e filluem të Shqiptarëvet. Mā në fund u-dërgue në Shqipni ushtria e madhe e e rrebtë e Tur-gut Pashës që punoj nji mij mizori e përdhuni kundër Shqiptarëvet; prej këtij rrebeshi që ngjau në verë të vjetit 1910 klubet u-mbullën dhe shkollat shqipe bashkë me Normalen e Elbasa-sanit nuk guxuen me u-hapë më për vjetin e ardhëshëm shkolluer.

Me gjith' atë, hovl i lëvizjes komtare u-për-mbajt për nji kohë, po nuk u-shtyp; Shqiptar-ët, si mbrënda ashtu edhe jashtë Shqipnisë, zunë prapë t'organizohen e të protestojnë me



Nxënësit e shkollës Normale më 1909-1910.

anë të deputetëve të tyne në Parlament të Turqisë dhe me anë të shtypit për shkeljen e të drejtave që kërkojshin për me u-njortë si komb më vete e me u shvillue me anë të gjuhës së vet. Prej këtij reaksioni që buçiti mbas fushatës së Turgut Pashës, Qeverija e Stambollit u shtrëngue t'ua njofi të drejtat Shqiptarëve e dha lejë që të hapet prapë shkolla normale, e kështu kjo u-hap prapë n'Elbasan, po shumë vonë, në Shkurt të vjetit 1912 e u përmbajt prej Qeverisë turke jo tue u-varë drejt për së drejti prej Ministrisë s'Arsimit të Stambollit, por tue u-dhanë përnjherësh një ndihmë prej 300 napolonash për përmbajtjen e shkollës.

Shkolla normale punoi atëhere, tue pasë tri klasë, një a 80 nxanës e një personel prej katër vetësh, deri në fund të vjetit shkolluer. Mbas luftës ballkanike dhe gjatë pushtimit të Shqipërisë së mesme prej Sërbëve, n'Elbasan nuk ka pasë veçse një shkollë plotore shqipe, që përmbahej prej popullit, por që nuk punoi si duhet, nga mungesa e mjeteve të mjafta dhe nga kundërshtimi i Sërbëve.

Më 1913-1914, mbas shpalljes së vetqeverimit të Shqipërisë dhe në ditët të Princ Wiedit, veç shkollave fillore shqipe të qytetit u-çel për të tretën herë Normalja, për këtë herë veçoi si

një kurs normal, si një normale gatimore me një klasë; kishie atëhere si kolla normale veç të jashtëmvet dhe 70 nxanës bursistë jo të mbrendshëm, se nuk kishte atëhere internat, por të jashtëm me një bursë prej 6 mexhitash në muaj. Veç landëvet të tjera atëhere për së parit u-mësuen landët pedagogjike, psikologjia dhe didaktika, por në menyre rudimentale. Nxënësit ishin mbledhë prej atyneve që kishin mbarue të paktën një qytetse turqishte a greqishte, me qellim që me këtë kurs vjetuer të mund të delshin mësues për shkolla katundesh. Kjo shkollë u-çel në vjeshtë të dytë, kishte vetëm tre profesorë dhe punoi mirë deri në lund të Majit, por u mbyll pa u-bamë provimet, nga shkak i rebelave që hynë atëhere n' Elbasan. Edhe sot kemi disa mësues të dalë prej kësaj shkolle.

Si u-thye fuqija e rebelave prej ushtrisë serbe dhe duel mbandaj ajo e Esatit, shkollat shqipe u-hapën prapë në Shqipëri të mesme; ashtu edhe n' Elbasan u-çel një shkollë plotore të cilën e gjeti hapë ushtria austriake, që hyri n' Elbasan në Janar të vjetit 1915. Në kohë të pushtimit austriak gjithë shkollat e Shqipërisë u-varën prej Drejtorisë së përgjithëshme t'Arsimit që e kishte qendrën në Shkodër. Por Normalja për mungesë lokale nuk u-hap veçse



Lutje për hapjen e Normales së dytë më 1910-1911.

në Mars të vjetit 1916. Kjo Normale e parë në kohë të Austriakëve nuk punoi si duhet, për shkak se i mungonte një ndërtesë e posaçme (mbassi ndërtesat e mira ishin zanë prej ushtrisë), i mungojshin fuqit' e duhuna mësimore si edhe nxanës të mjaftë e të përparuem; kjo ka pasë vetëm një klasë gatimore, tre profesorë dhe pak nxanës të jashtëm. Mbas provimit të fundit të kësaj shkolle u-ba n' Elbasan një kurs normal i shpejtë, që ngjati gjithë muejin e Qershorit e ku u-mblodhën mësuesit e katundevet të Prefekturavet të Beratit e t' Elbasanit. Vjetin tjetër, më 24 të vjeshtës së dytë 1917, u-çel prapë Normalja, po me një klasë, me tre profesorë e me pak nxanës të jashtëm dhe punoi deri më 8 Korrik 1917, kur u-banë provimet. Në këtë vjet shkolluer u-dha urdhën prej Drejtorisë së Përgjithshme të Shkodrës, që të mblidhen n' Elbasan gjithë mësuesit e të gjitha prefekturavet, për me u-ba prapë një kurs normal i shpejtë dy muejsh dhe si Drejtuer i këtij kursi u-dërgue atëhere nga Shkodra z. M. Logoreci. Mirë po, posa kishte fillue kursi në Gusht, u-përhap fjala se Austriakët u-thyen në Berat e kështu kursi u-shpërndi.

Duket qhtue këtu se në qoftë se Normalja

në kohë të Austriakëve nuk ka qënë një gjë me rregullë e me themel, por shkollat e tjera shqipe n' Elbasan, tri fillore e një qytetse, kanë pasë punue mirë e me rregullë, të selituna në ndërtesa të mira e të pajisuna me fuqi të plota mësimore. Po jo vëtëm n' Elbasan, por edhe në viset e tjera të Shqipnisë, të pushtueme prej Austriakëve, këta hapën kudo shkolla shqipe dhe, përgjithënisht, i vunë kujdes të math arsimit komtar.

Më 22 Nanduer 1918, kur kishin ikë Austriakët dhe kishin hymë Italianët, Normalja u-hap prapë n' Elbasan, me një klasë, me tri fuqi mësimore dhe me një a 25 nxanës; kjo ka qënë Normalja e tretë në kohë të pushtimevet të huaja dhe punoi kështu deri më 23 Jenar 1919; ç prej kësaj kohe Normalja u-var prej Delegatsisë s' Arsimit të Durrësit dhe u-bashkue me qytetsen triklasëshe, tue formue kështu një shkollë me katër klasë nën emnin Gjimnas-Normale, pse u-mësu n aty edhe mësimet e Gjimnazit, si p. sh. latinishtja. Kjo farë Normalje ka punue më mirë se tri Normallet e tjera, e selitun në një ndërtesë të mirë, me një a 80 nxanës e me 7 fuqi mësimore. Kët shkollë e ojti tue punue Kongresi i Lushnjës dhe urvar mbanandaj prej



Ceremonia e Normales së dytë më 1910-1911.

Ministrisë s' Arsimit të Qeverisë së Tiranës që duet nga ky Kongres. Për vjetin e ardhshëm shkolluer 1920-1921 kjo shkollë nuk vijoi ma me atë programë, por u-nda soje prapë qytetsja dhe Normalja u-hap vonë nga Dhetori i vjetit 1920 me dy klasë e me nji personel pesë vetësh.

Në vjetin shkolluer 1921-22 Normalja u-hap së parit me internat, kishte dy klasë, nji gatimore dhe nji klasë normale e pesë profesorë.

Më 1922-1923 Normalja ka pasë tri klasë, nji gatimore dhe dy klasë normale e shtatë fuqi mësimore.


Më 1923-24 Normalja u-bâ me katër klasë nji gatimore dhe tri klasë normale të mirëfillta. Në kët vjet u-themelue së parit shkolla ushtrimore me nji klasë, e me qenë se nxanësit e klasës së fundit ishin të rritshëm e kishin qenë nxanës edhe të qytetses së përparëshme, kët vjet duet në së parit normalistë, 15 vetë.

Në vjetin shkolluer 1924-1925 nuk duet në normalistë, pse Normales i u-shtue edhe nji klasë, nji gatimore dhe katër klasë normale. Kët vjet Normalja ka pasë 8 fuqi mësimore, Ushtrimorja dy mësues e dy klasë.

Më 1925-1926 Normalja nxorri 31 Normalistë; kët vjet Normalja pati prapë tetë fuqi mësimore dhe 2 mësues të Ushtrimores me dy klasë.

Qysh prej këtij vjeti deri sot, d. m. th. për 9 vjet rrjesht Normalja ka nxjerrë vjet për vjet rregullisht nga 25-30 normalistë. Duhet shtue se në vitin 1929-1930 Normalja u-ba me 6 klasë, mbassi kët vjet shkollat fillore, që kishin qenë me 6 klasë u-banë me 5, dhe e 6-a e Fillor. s i u ngjiti Normales si klasë gatimore.

Kjo ka qenë me pak fjalë historija e shkollës Normale, e cila tue qenë nji embrion sot 25 vjet ka ardhë tue u-përmirësue gradualisht, sa që sot ka 570 e sa nxanës, 15 klasë me nji sistemë tetë vjetësh studimi, e 23 profesore e mësues. Mos kujtoni se flasim nji gja te teprueme, kur themi se shkolla normale e jona me kulturën e përgjithshëmë dhe pedagogjike që jep nuk asht ma e ulët se ndonji tjetër shkollë normale e Ballkanit. Më tjetër anë s' duhet të mohojmë se me anë të shkollës normale asht përmirësue dhe asht futë në rrugë të mbarë arsimit i ynë filluer: prej Normales, qysh prej vjetit shkolluer 1923-24, kanë dalë deri sot 268 mësues; prej këtyneve 11 kanë vdekë, 17 kanë marrë nëpunësi të tjera dhe 238 janë mësues aktivë që kanë qenë nxanës të Normales më 1909 dhe më 1913. Prej gjithë këtyne 83 janë elbasanas. Me këta 251 mësues janë çelë-shkollat të reja dhe asht plotësue personeli i shko-



Nxënësit e Normales së dytë më 1910-1911.

llavet fillore nëpër qytete e katunde. Me anë të këtyne mësuesëve pra të dalun prej normales s' Elbasanit është luftue analfabetizmi i popullit dhe është përmirësue gjendja e shkollave t'ona fillore tue u-futë ndër to nji frym' e re didaktike që nuk e kanë pasë përparandej. Po mësuesit e dalun prej Normales nuk u kanë dhanë bijvet të popullit vetëm dituni fillestare, por kanë veprue mbi zemrat e tyre, kanë zgjue ndjenjat komtare dhe kanë predikue vllaznimin e bashkimin e elementave të kombit. Shkolla Normale, pra, sikundër që e andërrroshin ata që e hapën sot 25 vjet, është ba qendra e arsimit komtar: në këtë shkollë nuk është dhanë vetëm dituni, mësim, por janë zgjue e prefë ndjenjat e kombësisë, janë nallësue e zbritë ciësitë e rralla të racës s'onë, është futë dashuni ja mbë të mirën, mbë të drejtën, mbë gjuhën e mbë folklorën t'onë, janë vllaznue bijt e Shqipës t'ardhun prej gjithë visevet t' Atdheut, tue pasë nji qellim e nji ideal: ruejtjen e independencës shqiptare, bashkimin dhe përparimin e kombit.

Po mos kujtojmë se me kontigjentet e dalun për çdo vjet nga Normalja ka sosë arsimit filluer në nji shkallë të kullueme dhe s' ka nevojë përmirësimi. Arsimit i ynë filluer bashkë me normalen kanë edhe shumë të meta, që s'

po i permend, për mos me u-zgjatë më tepër. Po themi shkurt se duket të ndjekim edhe ne, duhet t'iu shkojmë edhe ne këmba këmbës gjithë atyne të përpjekunave e provave që kanë fillue mbas luftës me u bamë e po bahen edhe n' Evropën perëndimore për nji përmirësim. Për nji të përtërimë me themel të shkollës fillore, për t'a bamë këte ma të përshtatshëme konditave të përgjithshëme të jetës, për me e bamë gati fëminë ma mirë për jetën dhe me e ba anëtar të vjeshëm të grumbullisë komtare e shoqënore. Due të themi se në këto kohë të fundit janë çfaqë e janë theksue tendenca të reja në Pedagogji: është bisedue puna e është kuptue nevoja, që shkolla tradicionaliste, puna e së cilës përmblihet në tri pika: në këndim, shkrim e njehsim, t'ja lëshojë vendin shkollës aktive; që duhet të miret pa-a sysh psikologjia e fëmisë, nevojët e tij, interesat e tij dhe e drejta e tij me rrnuë i lirë dhe i lumtun; që duhet t'i shtjellohen fëmisë tanësisht e harmonisht gjithë fuqit' e tij fizike e shpirtnore, për me bamë sije nji gjasend të fortë, të zotin e të dobishëm për vehte a për shoqëninë njerëzore. Gjithë këtyne të përpjekunave e drejtimeve të reja pedagogjike duhet t'iu biem mbrapa, që të mund të riformohet edhe ndër ne arsimit fi-

luer, që të kthehet edhe shkolla e jonë tradicionale në një shkollë të re; shkollë e re do të thotë gjallni, jetë, do të thotë me ditë me rrejtë personalitetin e fëmijë dhe lirinë e tij. Po për një vepër të tillë të kapërthyme e të randë duhet një bashkëpunim i gjithë fuqive arsimore, një punë sistematike e paseshtun dhe mjete financiare.

Me gjithë atë s' lypset ta mohojmë se në këtë 20 e sa vjet të jetës s' onë të lirë shtetnore arsimi i ynë filluer ka bamë një farë përparimi: tue e krahasue kohën e tashme me të shkue-emen, një e shkueme që nuk asht fort larg, tue e merrë me mend gjëndjen embrionale të shkollës normale sot 25 vjet dhe gjëndjen e saj të sotshme të lulëzueme duhet ta njofim ndryshimin ndërmjet të kohës s' atëherëshme dhe të sotshme; duhet ta themi që përparimi nuk asht i vogël.

Por duhet të theksojmë se ky përparim në fushë t' Arsimit, si edhe në çdo degë t' aktivitetit t' onë si Shtet e si Komb asht vërtetue qysh sa zu të qeveris-t vëndi i ynë prej Mbretit t' onë të dashun Zogut të I-rë, Monarku i ynë gjenial ka vù për devizë pune përparimin kulturuer të popullit e ngritjen e Shqipnisë në shkallë të njëj shteti evropian të përparuem Për realizimin e këtij ideali Ai asht i patundun në qëllimin e Tij, tue mos u zbrapë përpara



Z. Prof. AHMET GASHI

Isb-drejtor i shkollës s' onë për 4-5 vjet me radhë Sot, Profesor në Institutin «Nana Mbretëshë».

çdo pengimi e tue e qitë në breg gjithëmonë anijen Shqiptare. Mbreti i ynë përparimdashës me syn' e Tij të patrembun dhe me ngulmin e Tij për realizimin e idealit kombtar na asht bamë të gjithëve shëmbëll e shkelqyeshme, që të punojmë pa-da për naltësimin ku'turuer të popullit dhe për lulëzimin mbarë të vëndit t' onë.

Me rastin e Njzet e pesë Vjeçorit të Normales s' Elbasanit.

I
Sa gëzim m' ndien zëmra, kùr un ndojhera Ty, o shkollë Normale t' kam në kujtim!
Ty, qi dhë dritë, qyshë në kohna të mjera
E plot renkim.

II
N' ato kohë të mjera, kùr veç robnija Shqipnin e dashtun e pat veshë në zi,
Njat herë kùr gratë, burrat e fëmija Thirshin "Liri".

III
Ti që e para strehë lumnijet
Me ty liriya e kombit agoi,
Ne ty Shqiptari, merzitë prej tiranijet
Kandshëm pushoi.

IV
Ti që çerdhja, kù s'ë pari djelmnija
Filloi të rritet me ndjenja kombtare
Me ty mori fillimin e vet historija
E gjuhës amtare.

V
Sà herë u mbylle nga duer gjaksore
Qi kurrë s' na i njoften të drejtat t' onë,
Por vranë e prenë, në mënyrë mizore
Porsi dragona.

VI
Ja, sot për ty e bukur dita gëdhini
Sot, plot po i mbushë ti njëzet e pesë vjetë
Harro pra vuetjetet e at kohë robnim!
Mburru përjetë!

VII
Për ty pra sot, të gjith' jemi bashkue
I math e i vogël, të mbushun me gëzim,
Njzet e pesë vjetorin me t'a krëmtue
Me brohim!

Bibliografi

Së shpejti qarkullojnë për shitje këto libra Arithmetike për shkollat fillore.


1) Arithmetika e kl. I Format 13×22 faqe 96 me katër ngjyra. Përmban një sasi të madhe figurash, me të cilat shpjegohet sistemi i zhvillimit të numurave, 1, 2, 3, 10.
Kushton 0,40 fr. ar.

2) Arithmetika e kl. II Format 13×22 faqe 108 me katër ngjyra. Kushton 0,80 fr. ar.

3) Arithmetika e kl. III Format 15×22 faqe 135 me tri ngjyra. Kushton 0,90 fr. ar.

4) Arithmetikë e kl. IV Format 13×22 faqe 145 me tri ngjyra. Kushton 1 fr. ar.

5) Arithmetika e kl. V Format 15×22 faqe 225 me dy e me tri ngjyra. Plot në ushtrime për t'u zbavitur. Kushton 2 fr. ar.
Këto janë hartuam prej studentit Shkollës Normale-Elbasan P.T.
Ja një nga kllshet e librave



Shtypëshkronja-Kartoleria PEPPO & MARKO

Shtypëshkronja janë shtyp me mjeshtëri të rallë çdo sent q'i përket kësaj mjeshtërie.

Çmime të pa-konkurrenshme.

Kartoleria janë të shtuara e plotësuar me mashinari Moderne, dhe kështu janë të përsosur për të bërë dhe rago ve shkollare, kartës shkrimi, radhoxje muzikës, regjistrave Tregëtare, si dhe çdo lloji q' i përket kartolerisë.

Pranojmë porosira nga gjithë viset e Shqipërisë.

Shitkë vetëm me shumicë.

**Biblioteka e të Rinjve: Kunorë Rinije, Nënë hijen e Nënës,
dhe Në krahët e një femre shiten në çdo librari. 3 cop L. 2**

LIBRARIA "RINIA"

Per mbi të gjitha
te

Z. Shefki Miraku
do gjeni

MODERACION

dhe KORREKTESE

në çmime

Vraponi, pra

Në këtë librari e çelun nashti së voni do gjeni:

Libra të ndryshme shqip e në gjuhëna të huaja, gazeta të ndryshme, revista, si dhe gjithë tekstet e orëndit shkollore.

Prandej kijeni në mendje kurdoherë Librarin «Rinia» e cila ju ofron çdo gjë që ju dëshëroni.

TE LIBRARIA "RINIA"